



VENDIM

Nr. 31 Datë 31.03.2014

PËR

FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENSIMIT TË SHOQËRISË “GURSHPATE ENERGY” SH.P.K NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC- “GURSHPATE 1” DHE HEC “GURSHPATE 2”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “a”, neneve 9 dhe 13 pikat 1, gërma “a”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 gërma “a”, nenit 8, nenit 9; nenit 10, pikat 1 të “Rregullores për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108 datë 09.09.2008, dhe nenit 18, pikat 1, gërma “a”, të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve, Nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 31.03.2014, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “GURSHPATE ENERGY” sh.p.k si dhe relacionin e Drejtorisë së Licensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licensimin në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike,

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “GURSHPATE ENERGY” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.
- Dokumentacioni teknik (nenin 9, pika 4.1.1) është paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



- Te dhena teknike per bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin (neni 9, pika 4.1.2) është paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.
- Dokumentacioni teknik dhe grafik (neni 9, pika 4.1.3) është paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.
- Dokumentacioni tekniko –ekonomik (neni 9, pika 4.1.4) është paraqitur dhe plotësuar pjesërisht,

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për licënsë të shoqërisë “GURSHPATE ENERGY”sh.p.k, per licensimin në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Hec-et “Gurshpate 1” dhe “Gurshpate 2”.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve te ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI